



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 840 prot.

Tiranë, më 27.03 .2024

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1706/3, DATË 09.11.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS PA VENDIM PËRFUNDIMTAR DHE ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. ISMAIL BUSHKOLA ”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur të z. Ismail Bushkola me nr. 189 prot., datë 19.02.2020 në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të ish magjistratit A.K. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe J.XH. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në kohën e kryerjes së shkeljeve të pretenduara dhe me vendimin nr. 1706/3, datë 09.11.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për përfundimin e procedurës pa një vendim përfundimtar ndaj prokurorit A.K dhe arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur ndaj prokurorit J.XH nga shtetasi z. Ismail Bushkola”, bazuar në nenin 122, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur përfundimin e procedurës pa vendim përfundimtar dhe arkivimin pas verifikimit të ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Megenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi; Rruga “Jaklin Persi”, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Konceptoi: Z. Feçi
Pranoi/Miratoi: E.Kuçi
2 (dy) kopje, datë 26.03.2024

